



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2658/2 prot.,

Datë 19.09.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Marketing&Distribution + Euromed” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-06449-05-24-2024, me objekt: “LOTI III: “Blerje pajisje didaktike për biologji, arsimit bazë dhe i mesëm”, me fond limit 50,609,996.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

**Ankimues:**

BOE “Marketing&Distribution + Euromed” SHPK me NIPT me NUIS J72124001N +K71718012P dhe adresë autostrada Tirane - Durrës, Km.10, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Adresa: “Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Në datën 18.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4572, si dhe nr.2658/2024 prot, datë 18.09.2024 i BOE “Marketing&Distribution + Euromed” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-06449-05-24-2024, me objekt: “LOTI III: “Blerje pajisje didaktike për biologji, arsimit bazë

dhe i mesëm”, me fond limit 50,609,996.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Marketing&Distribution + Euromed” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Marketing&Distribution + Euromed” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

*1. Operatori ekonomik BOE “MARKETING & DISTRIBUTION + EUROMED ”sh.p.k, me NUIS J72124001N +K71718012P, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT, për këto arsye:*

*I. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 7 e DT, pasi anëtari i BOE operatori ekonomik MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k, pjesëmarrës në BOE me 40%, nuk ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, (Anëtari i BOE ka detyrimin e plotësimit të kërkesave teknike në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në akt-marrëveshje, (neni 84, VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”). Konkretisht të gjitha kontratat e ngjashme të paraqitura nga MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k për qëllime kualifikimi, janë kontrata të fushës së kancelarive (letër, stilolapsa, bojë printeri, zarfa, dosje, kartona, materiale përodrim zyre, USB, etj) , të cilat qartësisht nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.*

*II. Gjithashtu në specifikimet teknike të artikujve të paraqitur vërehen mangësitë si më poshtë: - - Artikulli 21, Biologjia bazë, i cili korrespondon edhe me artikullin 33 Biologjia e mesme, Gota qelqi me nxënësi të ndryshme është përkthyer gabim fjala nxënësi.*

*- Artikulli 30 dhe 31, Biologjia bazë, të cilat korrespondojnë me produktet 42 dhe 43 të Biologjisë së mesme, emri është shënuar si në shqip “Proveza”*

*- Artikulli 37, Biologjia bazë, i cili korrespondon me artikullin 49 Biologjia e mesme, është shënuar Llama. Ky produkt njihet vetëm si “Microscope slides”.*

*- Artikulli 38, Biologjia bazë, i cili korrespondon me artikullin 50 Biologjia e mesme, është shënuar Lamella. Ky produkt njihet vetëm si “Cover glasses” ose “Cover slides”.*

- Artikulli 59, Biologjia bazë, e cila korrespondon me artikullin 93 Biologjia e mesme, është shënuar shqip *Parameci*, ndërkohë që emri i tij është “*Paramecium*”.

- Artikulli 95, Biologjia bazë, e cila korrespondon me artikullin 161 Biologjia e mesme, lëkurës së njeriut i është referuar me termin “*leather*”, term i cili përdoret për lëkurat që merren nga kafshët dhe përdoren për veshje ose përpunime të ndryshme industrial.

- Artikulli 55 tek biologjia bazë dhe korrespondetja e tij artikulli 67 tek biologjia e mesme, ku fjala *Pezafiltr* është lënë si në shqip, ndërkohë që kjo enë laboratorike në anglisht quhet “*Filtering bottle*”.

- Artikulli 63 Biologjia e mesme është referuar termi si “*Washing machine*”, term i cili përdoret për lavatrice. Ndërkohë që artikulli i kërkuar quhet “*Washing bottle*”

- Artikulli 36 Biologjia bazë dhe artikulli 48 Biologjia e mesme, është referuar kuisë për lama si “*Box for Llamas*”. Cfarë nënkuptohet me fjalën *Llamas*? Për kë produkt do të jetë kutia e ofruar? Cfarë do të mbajë *Brenda*?

- Artikujt 40, 41, 42 Biologjia bazë dhe korrespondentet e tyre artikujt 52, 53, 54 tek Biologjia e mesme. Termat që I referohen qelqit transparent dhe qelqit me ngjyrë nuk janë të sakta. Qelqi transparent referohet si *Colorless*, ndërkohë që quhet *Clear glass*, dhe qelqi me ngjyrë referohet si *Color glass*, ndërkohë që quhet *amber glass*. - Gabime të tjera hasim edhe në artikullin 104, Biologjia bazë ku termi “*Mëlci*” është shënuar shqip; gjithashtu edhe në artikujt 125,126,127,128 të Biologjisë së mesme ku fjala ndërtimi është referuar si “*Construction*”. Fjalë e cila vlen kur I referohesh ndërtimit të një ndërtese, por kurrsesi nuk mund ti referohesh ndërtimit anatomik të organeve humane.

Gabime të tilla drejtshkrimore krijojnë konfuzione sepse nuk arrin të krijosh saktësisht idene se çfarë produkti është ofruar nga kompania. Marrim ketu rastin konkret të artikullit 95 Biologjia bazë dhe Artikullit 161 Biologjia e mesme, ku lëkurës së njeriut i është referuar me termin “*Leather*”, term i cili nuk përdoret për lëkurën e njeriut. Për më tepër ky konfuzion përforcohet akoma më shumë kur në foton e katalogut, edhe pse është thjesht një foto referuese, është paraqitur procesi sesi përfitohet lëkura që merret nga kafshët. Pra në këtë rast konkret, përveçse problemet drejtshkrimore kanë krijuar konfuzion, por edhe lënë të kuptohet që artikulli i ofruar nuk është aspak i ngjashëm me atë që është kërkuar në DST. I njëjti arsyetim vlen edhe për produktin 55 tek Biologjia bazë dhe 67 tek Biologjia e mesme, ku jo vetëm emërtimi I artikullit është shkruar në gjuhën shqipe, por edhe foto e referuar nuk ilustron një pezafiltr, por një kupshore porcelani. Është e vërtet që thuhet se fotot, do të jenë thjesht ilustruese, por kjo jo detyrimisht jep të drejtën që ilustrimi i produkteve të bëhet totalisht gabim dhe të referohen në foto produkte që nuk janë të njëjta me atë që kërkohet, sepse dhe funksioni I tyre nuk është I njëjtë. -Artikulli 48 tek Biologjia bazë dhe korrespondetja e tij artikulli 60 tek biologjia e mesme. Për diametrin e këtij produkti një herë është shprehur se *diametric* do të jetë 125 mm, dhe në fjalën pasardhëse është shprehur se diametri mund të ofrohet edhe në diapazone 120 – 150 mm. -Artikulli 57 Biologjia bazë dhe korrespondetja e tij artikulli 69 tek Biologjia e mesme. Për diametrin e këtij produkti është referuar vlera 80 mm, dhe në vijmësi është shtuar se ky produkt mund të ofrohet edhe në diametër me diapason 80-90mm. Gjithashtu edhe për gjatësinë e shtypësit është referuar fillimisht që do të jetë në diapason 90-100 mm dhe në vazhdim të fjalisë është shtuar që mund të ofrohet edhe në

diapazonë 90-140 mm. Të gjitha këto dimensione janë shumë të paqarta. Fillimisht sepse duhet të jepet një vlerë fikse, që të kuptohet qartësisht se në çfarë dimensionesh do të vij produkti final. Së dyti nuk mund të referohet për një karakteristik të vetme njëherë një vlerë fikse dhe më pas të jepet si diapason. Sepse nga këto vlera të paraqitur cila duhet të merret si referuese? Tek cila duhet të bazohet? Artikuj ku mungojn pjesë përbërëse të tij. Përfshihet: - Artikulli 15 tek Biologjia bazë dhe artikulli 23 korrespondues tek Biologjia e mesme, mungojnë dy tuba nxehtësi duruese. 1. Artikuj që janë ofruar pjesërisht ose totalisht gabim. Përfshihet: - Artikulli 39 Biologjia bazë dhe korrespondentja e tij artikulli 51 Biologjia e mesme, është ofruar alkool natyral, ndërkohë që kërkohet alkool I denaturuar. - Artikulli 43 Biologjia bazë dhe 55 Biologjia e mesme, është vendos në emërtim dhe në specifikime “Glass bottle for colored liquid”, e cila nënkupton se shishja e qelqit do të jetë për lëngje me ngjyrë, por jo se shishja vetë do të jetë me ngjyrë, ashtu sikurse është kërkuar në DST. - Artikulli 58 Biologjia e mesme, është paraqitur në foto një mbajtëse me qeramik dhe tela metalike e cila përdoret për mbajtjen e enëve porcelain në laborator. Produkt ky I cili ska lidhje me kamje pirostin e kërkuar në DST. - Artikulli 144 Biologjia e mesme, është kërkuar që tabela mësimore të paraqes Aparatin e dëgjimit, e cila I referohet aparatit të dëgjimit tek njeriu, pra veshit dhe pjesët përbërëse të tij. Për këtë artikull është paraqitur një pajisje elektrike e cila shërben si apart për personat që kanë problematika me dëgjimin. - Artikulli 147, Biologjia e mesme, është kërkuar që tabela mësimore të paraqesi Aparatin e të parit, është paraqitur në foto një tabelë me shkronja e cila përdoret gjatë ekzaminimeve të syrit. Përsëri produkti i referuar nuk ka lidhje me anatomin e syrit që duhej të ofrohej. - Artikulli 141, Biologjia e mesme, është kërkuar të paraqitet krahasimi I zembrës tek vertebrorët. Në katalog në emërtim thuhet se mulazhet do të jenë zemrat e vertebrorëve, por në specifikime shënohet se artikulli do të ketë 5 loje të trurit të vertebrorëve. Cili nga organet do të ofrohet në këtë produkt? Kur në shtojcën numër 3693/4, datë 26.06.2024 është specifikuar dhe është sqaruar që ky artikull do të paraqesë 5 lloje zemrash të vertebrorëve. - Në lidhje me artikullin 76 Biologjia bazë dhe 137 Biologjia e mesme, në shtojcën numër 3693/4, datë 26.06.2024 është specifikuar dhe është sqaruar që ky artikull do të paraqesë mulazhin e qelizës bimore. Në specifikime nuk është në asnjë fjali e sqaruar që ky artikull I referohet qelizës bimore. - Për artikujt 86 dhe 87 të Biologjisë bazë, fotot e referuara nuk pasqyrojnë tematikën që është kërkuar. - Për gjithë artikujt e tabelave mësimore 85-115 Biologjia bazë dhe 144-172 Biologjia e mesme, nuk është specifikuar që këto tabela do jenë në gjuhën shqipe, dimensioned e tyre dhe nëse do jenë të plastifikuara me një shinë plastike dhe varëse të lëvizshme. - Artikulli 110 Biologjia bazë, është kërkuar të paraqitet Aparati I ekskretimit, pra kuptohet që përderisa këto tabela janë specifike për lëndën e Biologjisë, kjo kërkesë I referohet aparatit të ekskretimit të njeirut. Në këtë artikull është ofruar një produkt I gabuar. Produkti I ofruar në foto I referohet aparatit të ekstraktimit të yndyranceve, I cili quhet Sokslet ose me termin e tij anglisht “Soxhlet Apparatus”. Kjo përfocohet Akoma më shumë kur në specifikimet e shënuara në vijmësi, përshkruhet sesi ky aparat bën të mundur ekstraktimin e yndyrës nga fara ose produkte të ndryshme ushqimore. Pra kuptohet qartësisht që produkti I ofruar ska lidhje me atë që është kërkuar.

- III. Operatori ka paraqitur **OFERTË TË PARREGULLT DHE TË PAVLEFSHME** Konkretisht formulari i deklarimit të ofertës Shtojca I është në mospërputhje të plotë të vlerave të regjistruara

*në formularin e cmimeve dhe sasive Shtojca 2, ku në formularin e Dekalrimit të Ofertës ka deklaruar vlerën në total prej 1,991,234 lekë pa TVSH ndërsa në fomularin e Cmimeve Njësi dhe Sasive ka paraqitur një vlerë në total prej 37,728,532 lekë pa TVSH. Referuar paragrafit të fundit të Shtojcës 7 të DST Kritereve te Vecanta për Kualifikimi, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim” kjo ofertë do të refuzohet”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.09.2024.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**